Korrik 2020

Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian

PARTNERËT SHQIPËRI PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

Project Ahead Società cooperativa

Comitato don Peppe Diana

# CAUSE

# PËRDORIMI I PRONAVE TË KONFISKUARA PËR SIPËRMARRJE SOCIALE

Ky publikim u përgatit me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

©PARTNERËT SHQIPËRI PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

TIRANË, SHQIPËRI

GRAFIKA DHE FAQOSJA : MARIS SELAMAJ

# ORGANIZATA ZBATUESE, PARTNERËT DHE BASHKËPUNËTORËT

CAUSE – Përdorimi i Pronave të Konfiskuara për Sipërmarrje Sociale u zbatua nga Partnerët Shqipëri, në partneritet me Project Ahead dhe Comitato Don Peppe Diana, dhe në bashkëpunim me Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara. Projekti u financua nga Bashkimi Evropian.

**Partnerët Shqipëri Për Ndryshim dhe Zhvillim (PSh)** është një organizatë e pavarur jofitimprurëse shqiptare (OJF) e themeluar në vitin 2001, që mbështet shoqërinë civile dhe lehtësimin e bashkëpunimit ndër-sektorial me qëllim forcimin e institucioneve demokratike dhe përparimin e zhvillimit ekonomik. Partnerët ndërton platforma për komunitetet, organizatat e shoqërisë civile, qeverinë dhe biznesin për të promovuar ndryshime konstruktive. Partnerët Shqipëri sjell një ekspertizë dhe përvojë mbi 19-vjeçare të një organizate dinamike dhe inovative, të specializuar në fuqizimin e aktorëve të shoqërisë civile dhe angazhimin qytetar, lehtësimin e proceseve me pjesëmarrje dhe promovimin e transparencës dhe qeverisjes së mirë në nivel qendror dhe vendor, me qëllim forcimin e demokracisë në Shqipëri. Fushat kryesore programatike të punës së Partnerëve Shqipëri përfshijnë: (i) Mjedisi Mundësues dhe Zhvillimi i Qëndrueshëm i OShC-ve; (ii) Qeverisja Transparente dhe e Përgjegjshme; (iii) Sipërmarrja dhe Inovacioni Social (iv) Zhvillimi i Filantropisë dhe (v) Rritja e Mundësive të Punësimit për të Rinjtë. Partnerët Shqipëri është anëtare e Partners Global, një rrjet i 22 organizatave të pavarura në Evropë, Amerikën Veriore dhe Jugore, Afrikë e Lindjen e Mesme, të cilat punojnë për një ndryshim paqësor e demokratik. Partnerët Shqipëri është gjithashtu anëtare e disa rrjeteve evropiane dhe rajonale si Euclid, BCSDN, ECAS, Diesis, Ana Lindh Network, etj.

**Project Ahead** është një kooperativë e themeluar në 2001, me vendndodhje në Napoli e cila ofron këshilla për organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare në konceptimin, përgatitjen dhe menaxhimin e projekteve komplekse.

# ORGANIZATA ZBATUESE, PARTNERËT DHE BASHKËPUNËTORËT

Project Ahead shërben si një partner i kualifikuar në mbështetje të sektorit të tretë, vullnetarizmit, bizneseve - në veçanti kooperativave - dhe institucioneve publike, përmes ofrimit të shërbimeve të specializuara që synojnë rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit të aksioneve për zhvillim të lidhura kryesisht me Fondet Strukturore Evropiane dhe Programet Komunitare. Aktiviteti i saj është i orientuar në veçanti në zhvillimin e ndërhyrjeve që lidhen me rininë dhe politikat sociale, zhvillimin ndërkombëtar të partnerëve privatë dhe bashkëpunimin ndërkombëtar midis entiteteve të ndryshme.

**Comitato Don Peppe Diana** është një shoqatë, e themeluar zyrtarisht në vitin 2006 si rezultat i një periudhe disa vjeçare pune, e cila përfshin njerëz dhe organizata të bashkuara nga dëshira për të mos harruar martirizimin e Don Peppe Diana, një prift i cili vdiq për dashurinë ndaj popullit të tij. Shoqata ndodhet në Bashkinë Casal di Principe dhe është fuqimisht e përkushtuar në rikthimin e dinjitetit dhe mbështetjen e zhvillimit të shëndetshëm të kapitalit social dhe marrëdhënieve në territoret ku mafia ka prodhuar dhunë dhe gjeneruar mosbesim, duke ndikuar në aftësinë e njerëzve për të krijuar marrëdhënie të bazuara në ligjshmëri dhe respekt.

**Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK)** është themeluar në vitin 2008 bazuar në Ligjin Nr. 9284, datë 30.09.2004 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar" ndryshuar me Ligjin nr. 10 192 datë 03.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë". AAPSK është një institucion shtetëror nën përgjegjësinë e Ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike, dhe është përgjegjëse për administrimin dhe / ose përdorimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara nga krimi i organizuar, të tilla si: llogari bankare, automjete, toka, ndërtesa, makineri, pajisje si dhe ndërmarrje të konfiskuara. Selia e saj është në Tiranë.

# PËRMBLEDHJE E CAUSE

CAUSE - Përdorimi i Pronave të Konfiskuara për Sipërmarrje Sociale është iniciativa e parë e kësaj natyre e zbatuar në Shqipëri dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor, e cila krijoi një model të ri-përdorimit të qëndrueshëm të pronave të konfiskuara nga krimi i organizuar nga organizatat e shoqërisë civile (OSHC-të) si një mjet i vlefshëm për të riafirmuar vlerën e ligjshmërisë dhe iniciativës qytetare kundër krimit të organizuar.

CAUSE u krijua bazuar në idenë se ripërdorimi i pronave të konfiskuara nga krimi i organizuar paraqet një mundësi të qartë për të ndryshuar një paradigmë ekonomike dhe për të treguar se ekonomia ligjore mund të jetë më efikase se ajo e paligjshme, duke bashkuar interesin publik dhe qëndrueshmërinë ekonomike.

Përmes një qasje inovatore të fokusuar në promovimin dhe zhvillimin e kulturës së sipërmarrjes sociale dhe luftës kundër krimit të organizuar, CAUSE ofron mundësi, aftësi dhe mbështetje financiare për OSHC-të për të filluar një projekt të ri në një pronë të konfiskuar nga krimi i organizuar.

CAUSE arriti të transformojë tre prona të konfiskuara nga krimi i organizuar në tre qytete të ndryshme të Shqipërisë në mjedise që ofrojnë:

- Mundësi edukimi/formimi, punësimi dhe integrimi për grupet e margjinalizuara të prekura ose në rrezik për t'u prekur nga krimi i organizuar;
- Produkte dhe shërbime për qytetarët;
- Aktivitete sociale, kulturore dhe ndërgjegjësuese për komunitetin.

Ky botim paraqet elementët dhe arritjet kryesore të CAUSE. Ai ofron të dhëna dhe shifra mbi përfituesit e kësaj iniciative, informacion mbi skemën e nën-grantimit, ndikimin në komunitet dhe dëshmi nga partnerët, bashkëpunëtorët dhe përfituesit.

# DY SHTYLLAT KRYESORE TË CAUSE

1 **Mbështetja e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara**

2 Përgatitja dhe Menaxhimi i Skemës së Nën-Grantimit për Ngritjen e Sipërmarrjeve Sociale nga OShC-të në Pronat e Konfiskuara nga Krimi i Organizuar.

# MBËSHTETJA E AGJENCISË SË ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE TË KONFISKUARA

- **Trajnim me administratorët e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara për ripërdorimin social të pronave të konfiskuara.**

  ***10 administratorë***

- **Ofrimi i udhëzimeve për të mbështetur përgatitjen e procedurave të brendshme për caktimin dhe kalimin e pronave të konfiskuara tek OSHC-të për ri-përdorim social.**

- **Vizitë studimore në Itali.**

  ***2 anëtarë të stafit të Agjencisë***

- **Vendosja e linjave të komunikimit me OSHC-të.**

# WORKSHOPE ME OSHC-TË

**6** DITË TRAJNIMI

**106** PJESËMARRËS

**5** QYTETE: Tiranë, Durrës, Shkodër, Vlorë, Fier.

# SKEMA E NËN-GRANTIMIT

**4** Thirrje për Propozime të shpallura

**5** PRONA TË KONFISKUARA

**13** SESIONE INFORMIMI

**146** PJESËMARRËS



# 300,000 EUR
## FONDI TOTAL

→

**60,000 - 150,000 EUR**
**BUXHETI PËR PROJEKT**




**23** APLIKIME

**3** PROJEKTE FITUESE

**5** ORGANIZATA ZBATUESE

**12-15 MUAJ**
KOHËZGJATJA E MBËSHTETJES FINANCIARE TË CAUSE

**5 VJET**
KONTRATË ME AAPSK PËR RI-PËRDORIMIN E PRONAVE TË KONFISKUARA PA PAGESË

# FIRMOSJA e KONTRATAVE me PROJEKTET FITUESE

# INAGURIMI i SIPËRMARRJEVE SOCIALE

# 28

## SESIONE MENTORIMI

zhvilluar online dhe onsite me organizatat përfituese të skemës së nën-grantimit



# 1

## VIZITË STUDIMORE

## në Itali me organizatat partnere dhe përfituesit



# KONFERENCA PËRMBYLLËSE E CAUSE



Invest in Albania

SOCIAL BUSINESS

## Assets Seized from Organized Crime to Help Create Social Enterprises

SEPTEMBER 18, 2017

TIRANA, September 18

Assets confiscated from organized crime will help to create social enterprises. Those assets that are now administered by the Agency for the Administration of Seized and Confiscated Assets will serve to the people and social groups that have been affected by criminal activities such as human trafficking, substance abuse, etc.
This new project named 'Confiscated Assets used for Social Experimentation Project' (C.A.U.S.E) is implemented by Partners Albania in partnership with two Italian organizations: Comitato Don Peppe Diana and Project Ahead, and it is funded by the European Union (EU).

OPINION

Aktualitet

## Pronat e sekuestruara të krimit do tu jepen OJF-ve

62

PARAQITJE MEDIATIKE



SCAN

## Prona e konfiskuar nga krimi i organizuar në Shqipëri kthehet në kafe-librari!

SarandaWeb

# SIPËRMARRJET SOCIALE të ngritura nga CAUSE

## KeBuono
## Pastiçeri sociale

KeBuono është një pastiçeri sociale që zhvillon veprimtarinë e saj në një pronë të konfiskuar nga krimi i organizuar në Fier. Ajo ofron një shumëllojshmëri produktesh si dhe një seri aktivitetesh integruese me fëmijë dhe prindër, adoleshentë, studentë, gra dhe vajza duke synuar ndërtimin në komunitet të një kulture të ligjshmërisë dhe kundër dhunës.
Trajnime të formimit dhe aftësimit profesional u ofrohen të rinjve që janë ish të dënuar ose familjeve të të burgosurve aktualë që përballen me kushte të vështira jetese.
Duke kombinuar elemente të ndryshëm si: adresimi i konfliktit shoqëror për shkak të krimit të organizuar, punësimi i njerëzve në nevojë dhe promovimi i vlerave dhe të drejtave brenda komunitetit, KeBuono kontribuon në kapërcimin e dyshimeve mbi ripërdorimin e pronave të konfiskuara nga krimi i organizuar në qytetin e Fierit.

**75%** e personelit janë **të rinj, gra dhe vajza** në rrezik apo viktima të krimit të organizuar dhe dhunës në familje në qytetin e Fierit.

## Gjatë vitit të parë TË ZBATIMIT

**4** gra dhe vajza të rrezikuara apo viktima të krimit, të punësuara;

**16** të rinj të kualifikuar përmes trajnimeve profesionale nga të cilët 7 të rinj të punësuar;

**9** shkolla dhe qendra në Fier kanë mundësuar përfshirjen e më shumë se 700 fëmijëve në aktivitete integruese dhe informimin e mbi 1,000 të rinjve për çështje të ndryshme sociale me qëllim ndërtimin e një kulture të ligjshmërisë dhe kundër dhunës midis të rinjve;

**4** fushata ndërgjegjësuese të organizuara për të promovuar kulturën Rome, parandalimin e abuzimit me drogën dhe alkoolin, integrimin në shoqëri të personave me nevoja të veçanta dhe ndërgjegjësimin mbi dhunën me bazë gjinore.

Buxheti total: 150,000 EUR

Kontributi i BE: 142,500 EUR (95%)

Produktet më të shitura: Croissants (970) | Akullore (750) | Kek (430) | Tortë Ditëlindje (60)

Periudha e zbatimit: 16 Janar 2018 – 31 Korrik 2019

Organizata zbatuese: Enti Kombëtar i Jozefinëve të Murialdos ENGIM në partneritet me Qendrën Sociale Murialdo

# KeBuono
# PASTIÇERI SOCIALE

# SIPËRMARRJET SOCIALE të ngritura nga CAUSE

## KinFolk
## KAFE LIBRARI

**Kafe Librari KinFolk** është një iniciative e ngritur ne një pronë të konfiskuar nga krimi i organizuar në Durrës, e transformuar në një mjedis miqësor për të rinjtë, veçanërisht ata që janë në rrezik ndaj kriminalitetit të të miturve, familjet e tyre dhe qytetarët. Duke i angazhuar ata në nisma sociale, kulturore dhe edukuese, Kinfolk shërben si një masë parandaluese ndaj përfshirjes së të rinjve në aktivitete kriminale. Kafe Librari Kinfolk është një qendër shumëfunksionale ku të rinjtë mund të takohen, të përfitojnë nga një gamë e gjerë trajnimesh, kursesh mësimore dhe aktivitetesh social-kulturore dhe të kalojnë kohën e lirë. Kinfolk shërben si një vend për punësim, ri-integrim dhe pasurim të jetës shoqërore të të rinjve, pjesë e shërbimit të provës. Kafe Librari Kinfolk Coffee është e hapur për të gjitha organizatat, shkollat dhe institucionet që të zhvillojnë aktivitetet e tyre në këtë mjedis.

**Një mjedis i përshtatshëm ku të rinjtë mund të ndërveprojnë, mësojnë dhe punojnë.**

## Gjatë vitit të parë TË ZBATIMIT

**3** të rinj nga grupe të margjinalizuar të punësuar;

mbi **150** të rinj & studentë janë angazhuar në aktivitete edukuese, artistike dhe kulturore;

**7** programe trajnimi për studentët për rritjen e aftësive të tyre drejtuese, advokuese dhe lobuese, sipërmarrje sociale, pjesëmarrja në qeverisjen qendrore dhe vendore, përgatitja për punë, etj;

**27** programe kursesh në gjuhë të huaja dhe shkenca ekzakte me të rinjtë;

**Buxheti total: 89,717.250 EUR**

**Kontributi i BE: 85,231.37 EUR (95%)**

**Periudha e zbatimit: 3 Maj 2019 – 31 Maj 2020**

**Organizata zbatuese: Fondacioni Arsimor Shqiptar në partneritet me Qendrën për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës**

# KinFolk
# KAFE LIBRARI






# SIPËRMARRJET SOCIALE të ngritura nga CAUSE



## Garazhi Social i Artizanatit

**Garazhi Social i Artizanatit** është një punishte e ngritur në një pronë të konfiskuar nga krimi i organizuar në Sarandë, ku gra dhe vajza – viktima apo në rrezik nga krimi i organizuar dhe dhuna në familje, prodhojnë punime artizanale duke përdorur gurët e detit (shumëngjyrësh, njëngjyrësh, të sheshtë, shkëmborë, qelqi, etj.). Gurët ngjyrosen, çpohen, gdhenden dhe punohen duke krijuar produkte të ndryshme artizanale të gatshme për treg. Modelet e punimeve ndërlidhen me trashëgiminë kulturore dhe folklorin duke i bërë këto produkte unike, të vlefshme dhe konkurruese në tregun artizanal, në mënyrë që të sigurohet gjenerimi i të ardhurave në nivel afatgjatë. Duke i dhënë një fytyrë të re pronës së konfiskuar, sipërmarrja përçon një mesazh të fuqishëm mbi vlerën që ka ri-përdorimi i këtyre aseteve në mbështetje të përfshirjes sociale dhe zhvillimin e ekonomisë lokale.

**Garazhi Social i Artizanatit Sarandë shërben si një Hub Social në mbështetje të integrimit ekonomik dhe social të grave dhe vajzave në jetën e qytetit.**

## Gjatë vitit të parë TË ZBATIMIT

**8** vajza dhe gra viktima apo në rrezik nga krimi i organizuar dhe dhuna në familje të trajnuara dhe punësuara mbi prodhimin artizanal të gurit;

mbi **2,500** produkte artizanale të prodhuara me gurë deti;

**2** programe trajnimi mbi trashëgiminë kulturore dhe të drejtat e njeriut;

**2** ekspozita lokale.

Buxheti total: 59,978.86 EUR

Kontributi i BE: 56,979.92 EUR (95%)

Periudha e zbatimit: 3 Maj 2019 – 31 Maj 2020

Organizata zbatuese: Instituti i Zhvillimit, Migracionit dhe Integrimit (IMZHI)

# Garazhi Social i Artizanatit

# IMPAKTI I CAUSE

CAUSE mposhti skepticizmin dhe ndryshoi mentalitetin dhe qasjen e institucioneve shtetërore ndaj administrimit të pronave të konfiskuara. Kuadri i ri ligjor që rregullon punën e AAPSK-së është ndikuar nga përfshirja dhe përvoja e saj me CAUSE. AAPSK është e gatshme dhe e përgatitur të institucionalizojë bashkëpunimin e saj me OSHC-të, madje edhe pse nuk specifikohet në ligj, ripërdorimi social i pronave të konfiskuara është opsioni prioritar i AAPSK-së për administrimin e tyre, përkundrejt opsionit të shitjes, siç ishte përpara zbatimit të CAUSE.

CAUSE përçoi një mesazh të fortë politik se ajo që i është marrë komunitetit mund dhe duhet t'i kthehet komunitetit, përmes guximit dhe forcës së aktorëve të shoqërisë civile që sfiduan institucionet shtetërore dhe treguan se janë një partner i besueshëm në luftën kundër krimit të organizuar dhe riintegrimit të viktimave të krimit në komunitetet e tyre.

CAUSE tregoi vlerat sociale, ekonomike dhe politike të ripërdorimit social të pronave të konfiskuara nga OShC-të, një praktikë që duke marrë parasysh burimet e kufizuara financiare të OShC-ve, mund të konsolidohet me mbështetjen financiare të komunitetit të donatorëve duke ruajtur dhe respektuar pronësinë lokale.

CAUSE është një model pilot në Shqipëri dhe vendet e Ballkanit Perëndimor me potencialin për tu shndërruar në një program rajonal të ripërdorimit social të pronave të konfiskuara nga krimi i organizuar nën udhëheqjen e organizatave lokale.

# DËSHMI

***"Ne besojmë fuqimisht në ripërdorimin social të pronave të konfiskuara nga krimi i organizuar.***
***Vlera e vërtetë e CAUSE është perceptimi i publikut se krimi i organizuar mund të luftohet dhe mposhtet; dhe se ajo që është vjedhur nga krimi i organizuar i kthehet shoqërisë. Mendoj se ky është koncepti i projektit."***

*Shkëlqesia e Tij Zoti Luigi Soreca*
Ambasador i Bashkimit Evropian në Shqipëri

***"Falë guximit të këtyre organizatave që kanë një dimension social dhe madje një buxhet të kufizuar, ne mund të ndërtojmë një ekonomi alternative që mund të shërbejë si një antidot ndaj organizatave kriminale."***

*Michele Mosca*
*Comitato Don Peppe Diana dhe Universiteti i Napolit "Federico II"*

***"Ne kemi provuar se shoqëria civile ka guximin të angazhohet fuqimisht në luftën kundër krimit të organizuar."***

Juliana Hoxha
Drejtore e Partnerëve Shqipëri

***"Para projektit CAUSE, shitja e pronave ka qenë opsioni kryesor derisa filluan këto projekte sociale. CAUSE ka ndryshuar në mënyrë drastike prioritetet e Agjencisë."***

*Artur Kala*
Drejtori i AAPSK

# DËSHMI

***"Mënyra më e mirë për të promovuar këtë aktivitet është t'u japësh njerëzve histori suksesi. Pasi dikush ia del mbanë, gjithmonë mund të themi: shikojeni, ai e bëri ! Dhe kështu, edhe ju mund ta bëni!"***

*Marco Traversi*
*Project Ahead*

***"Në nëntor 2017 morëm pjesë në një sesion trajnimi për ripërdorimin e pronave të konfiskuara nga krimi i organizuar. Ne vizituam pronën në të njëjtën ditë. Ishte një vend krejt i errët dhe i braktisur. Ne reflektuam në lidhje me të sepse ishte një detyrë e vështirë dhe e rrezikshme. Por, ne vendosëm të vazhdojmë."***

Roberto d`Amato
Koordinator Projekti
ENGIM Internazionale

***"Ne u përballëm me pengesat e para nga stafi në lidhje me faktin se na duhej të merreshim me një pronë të konfiskuar. Të gjithë thoshin se ne nuk do ta zbatojmë këtë projekt. Të tjerët madje vunë në dyshim nevojën për t'u përfshirë me një pronë të tillë. Por dikush duhet të fillojë ta bëjë. Kështu që ne përgatitëm dhe dorëzuam propozimin."***

*Nensi Dragoti*
*FASh*

# DËSHMI

***"Më duhet të punoj për të ndjekur studimet dhe për t'i financuar ato. Projekti dukej mjaft i mirë, në shërbim të qytetarëve dhe studentëve duke ofruar trajnime dhe kurse të formimit profesional të cilat mund ti ndiqja dhe unë. Mua do të më pëlqente shumë të vazhdoja angazhimin tim në këtë projekt të shkëlqyeshëm pasi më ka ndihmuar shumë deri tani."***

Enio Bleta
Kamarier tek  Kafe Librari Kinfolk

***"Të gjitha gratë dhe vajzat kanë marrëdhënie shumë të mira në vendin e punës. Na është dhënë një shans dhe një mundësi shumë e mirë për të ecur përpara, për të rritur kreativitetin tonë dhe për të investuar në veten tonë."***

Aleksandra Mazaj
Artizane tek Garazhi Social i Artizanatit

***"Një vit më parë fillova të punoj si ndihmës pastiçiere tek pastiçieria KeBuono. Ky mjedis i organizuar më së miri dhe miqësor më bëri të përjetoj një vit të jashtëzakonshëm, plot surpriza dhe arritje. Ne u trajnuam profesionalisht për katër muaj dhe gjatë kësaj kohe mësova shumë teknika të reja. Jam vërtet e lumtur!"***

Besnike Kume
Pastiçiere tek Pastiçeria Sociale KeBuono

***"Kjo sipërmarrje sociale do t'u japë shpresë dhe forcë për të ndaluar dhunën."***

Drita Avdyli
Instituti i Zhvillimit, Migracionit dhe Integrimit

# SHTOJCA 1

# CAUSE në Media

## PREZENCA NË TV&Radio

1.https://www.scan-tv.com/prona-e-konfiskuar-nga-krimi-i-organizuar-ne-shqiperi-kthehet-ne-kafe-librari/
2.https://www.rtsh.al/lajme/pronat-e-krimit-ne-sherbim-te-komuntetit/
3. https://oranews.tv/article/diskoja-e-grupeve-kriminale-ne-durres-kthehet-ne-kafe-biblioteke
4. https://www.youtube.com/watch?v=P7co0RP1b4I&feature=emb_title
5. https://www.youtube.com/watch?v=P7co0RP1b4I&feature=emb_title
6. https://youtu.be/1wrPYTLIJZU
7. https://www.youtube.com/watch?v=G5AE-JrxhjI
8. https://oranews.tv/article/diskoja-e-grupeve-kriminale-ne-durres-kthehet-ne-kafe-biblioteke
9. https://www.youtube.com/watch?v=BKEPiKLxbFs
10. https://www.youtube.com/watch?v=LauB4vxRun4
11. https://www.youtube.com/watch?v=BpFMqswTqIU
12. https://www.facebook.com/104621144291014/videos/246442509944369/
13. https://it-it.facebook.com/miremengjesshqiperi.rtsh/videos/n%C3%AB-studion-e-mir%C3%ABm%C3%ABngjes-shqip%C3%ABri-me-moderatoren-blerina-shehu-dhe-juliana-hoxha/1448547001936390/
14. https://www.facebook.com/blendi.salaj/videos/2156216001085981/?hc_ref=ARQ4Icb5voZliByvTrBnm3ISIBcI5gf2V4meX1xlORrRIh61MEjG8M7XFUgzxtu6rVY
15. https://www.facebook.com/TeleJoniTV/videos/1588559287874869/
16. https://www.youtube.com/watch?v=Av3OTe15n_Q
17. http://www.oranews.tv/vendi/pasurite-e-krimit-pronat-e-sekuestruara-do-tu-jepen-ojf-ve/
18. https://www.youtube.com/watch?v=G2awL_Gu5cg
19. https://www.youtube.com/watch?v=SKbDSTcFgD8&feature=youtu.be
20. https://youtu.be/UqUYuCXsSXk?t=9
21. https://www.youtube.com/watch?v=BQWWhJQy5RQ
22. https://www.youtube.com/watch?v=uVktQ9R81Z0&fbclid=IwAR2YiGrhjQIyCKo8WJC9quiFy59WKJxjElyIWkbosryu85ZmD6kGx75ROJE
23. https://www.youtube.com/watch?v=YbnclKJ7rWg&fbclid=IwAR3_ZC0ry2NKE-j0FhvvVM71eSuO4ADVkfF6H0Vrk4-EkSDUT78XfXRmUvc
24. https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=132028278216967&id=104621144291014
25. https://www.youtube.com/watch?v=LVYfYsVKKrQ

# Portalet Online


1. https://ata.gov.al/2019/11/09/hapet-ne-durres-nje-sipermarrje-e-re-sociale/
2. https://ata.gov.al/2019/11/08/riperdorimi-social-i-pasurive-te-konfiskuara-be-mbeshtet-hapjen-e-qendres-kulturore-per-te-rinjte-ne-durres/
3. https://alpenews.al/disko-e-sekuestruar-nga-krimi-ne-durres-kthehet-ne-bibloteke-soreca-hap-i-vogel-por-i-rendesishem/
4. https://sot.com.al/politike/cfare-do-perdoren-pronat-e-sekuestruara-te-personave-me-precedente-penale-soreca-ky-eshte
5. https://bulevardionline.com/nga-lokal-nate-ne-biblioteke-pronat-e-sekuestruara-do-perdoren-per-mjedise-sociale-soreca-do-keni-mbeshtetjen-e-be/
6. https://dritare.net/celet-per-here-te-pare-ne-durres-libraria-ne-pronen-e-konfiskuar-nga/
7. https://elbasaninews.al/hapet-ne-durres-nje-sipermarrje-e-re-sociale/
8. http://bulqiza.info/2019/11/08/durres-prona-e-sekuestruar-kthehet-ne-biblioteke-soreca-do-keni-mbeshtetjen-e-be/
9. https://next-television.com/durres-disko-e-sekuestruar-nga-krimi-kthehet-ne-biblioteke-per-rinjte-soreca-hap-i-vogel-por-i-rendesishem/
10. https://theworldnews.net/al-news/bizneset-sociale-pas-embeltores-ne-fier-be-financon-dhe-dy-projekte-ne-durres-dhe-sarande
11. https://gotanews.tv/pronat-e-sekuestruara-soreca-do-keni-mbeshtetjen-e-be-per/
12. https://balkanweb.com/nga-lokal-nate-ne-biblioteke-pronat-e-sekuestruara-do-perdoren-per-mjedise-sociale-soreca-do-keni-mbeshtetjen-e-be/
13. https://shqiptarja.com/lajm/durres-diskoja-e-sekuestruar-nga-krimi-kthehet-me-biblioteke-per-rinjte-soreca-hap-i-vogel-por-i-rendesishem?r=kh4
14. https://lapsi.al/2019/11/08/diskoja-e-grupeve-kriminale-ne-durres-kthehet-ne-kafe-biblioteke/
15. https://konica.al/2019/11/negociatat-soreca-vlereson-nismen-e-shqiperise/
16. https://durreslajm.al/sociale/ish-diskoja-qe-u-kthye-ne-kinfolk-coffee-library-ne-durres-soreca-jep-mesazhin-te-rinjte
17. http://www.tiranapost.al/diskoja-u-kthye-ne-biblioteke-soreca-flet-per-rendesine-e-kesaj-nisme/
18. http://www.albeu.com/kryetitull/koha-per-te-rinjte/490300/
19. https://vymaps.com/AL/Social-Crafting-Garage-Saranda-110378363822103/
20. http://en.ata.gov.al/2020/02/07/8-women-employed-in-saranda-soreca-another-confiscated-asset-of-organized-crime-is-returned-to-community/

# Portalet Online


21. https://www.govserv.org/AL/Tirana/503774383058720/Agjencia-e-Administrimit-te-Pasurive-te-Sekuestruara-dhe-te-Konfiskuara
22. https://theworldnews.net/al-news/bizneset-sociale-pas-embeltores-ne-fier-be-financon-dhe-dy-projekte-ne-durres-dhe-sarande
23. https://www.balkanweb.com/cndodh-me-pasurite-e-konfiskuara-te-krimit-drejtoresha-e-fondacionit-po-i-kthejme-ne-ndermarrje-sociale-qeveria-nen-presion-per-anti-kck/
24. https://javanews.al/ja-cfare-do-ndodhi-me-pasurite-e-konfiskuara-te-krimit-flet-drejtoresha-e-fondacionit-po-i-kthejme-ne-ndermarrje-sociale/
25. http://fierisot.com/2018/10/30/inagurohet-pasticeria-ke-buono-biznesi-social-me-i-ri-ne-qytetin-e-fierit/
26. https://invest-in-albania.org/assets-seized-organized-crime-help-create-social-enterprises/
27. http://www.monitor.al/projekti-i-ri-mbi-asetet-e-krimit-te-organizuar-do-lulezojne-sipermarrje-sociale/
28. https://www.ata.gov.al/eu-to-fund-draft-projects-on-confiscated-assets-usage/
29. http://www.standard.al/2017/09/15/pronat-dhe-asetet-kriminale-te-konfiskuara-do-tu-jepen-ojf-ve/
30. http://opinion.al/pronat-e-sekuestruara-te-krimit-do-tu-jepen-ojf-ve/
31. https://elbasaninews.al/prona-e-konfiskuar-nga-krimi-i-organizuar-be-nje-sipermarrje-sociale-per-grate-e-te-rinjte-ne-fier/
32. https://sarandaweb.net/ne-pronat-e-krimit-celet-ne-sarande-garazhi-social-i-artizanatit/
33. https://a2news.com/2020/02/09/prona-e-trafikantit-qender-per-grate-e-trafikuara/
34. http://albest.al/827-1/aktualitete/26872-prona-e-trafikantit-kthehet-ne-qender-per-grate-e-trafikuara.html
35. https://360grade.al/333537/prona-e-trafikantit-kthehet-ne-qender-per-grate-e-trafikuara/
36. https://www.botasot.info/shqiperia/1232648/prona-e-trafikantit-kthehet-ne-qender-per-grate-e-trafikuara/

PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM
Rruga e Elbasanit, Park Gate , kati i 10-të,
Ap. 71 / 73, Kutia Postare 2418/1
1010 Tiranë, Shqipëri